



BASHKIA RROGOZHINE
DREJTORIA E POLITIKAVE URBANE

RELACION SHPJEGUES



Rehabilitim i rruges se fshatit Rrostej te Njesise Administrative Sinaballaj

Objekti ndodhet në gjendje të amortizuar, prej vitesh në to nuk janë kryer investime. Në këtë rrugë vlen të theksohet mungesa e shtresave asfaltike dhe kanalizimeve .

Kushtet,ambientale

Nga pikpamja urbane zona ku ndodhet rruga karakterizohet nga nje dendesi e ulet popullsie si rezultat i ndertimeve ekzistuese me banesa te vjetra . Nje nga problemet me thelbesore qe nuk eshte zgjidhur definitivisht eshte infrastruktura.

Zhvillimi urban

Zona karakterizohet nga nje zhvillim urban pjeserisht i detajuar dhe i kontrolluar me perjashtim te rasteve sporadike te ndertimeve pa leje. Shumica e ndertesave jane banesa ekzistuese te ndertuara para shume kohesh. Jane tipike ndertesa 1 kateshe. Gjeresia e rruges nuk i kalon 4 m.

Gjendja e sistemit rrugor (rruge-trotuare)

Infrastruktura rrugore ekzistuese eshte totalisht e degraduar. Rruga ekzistuese eshte konceptuar per nje trafik normal.

Ne pjese te vecanta te rruges, mungesa e rrjetit te kanalizimeve ka bere qe te fillojne te prishen se ekzistuari edhe ato segmente rruge qe mund te konsideroheshin te tilla, nderkohe nga pikpamja teknike mund te thuhet se mungojne shtresat rrugore.

Rrjeti i kanalizimeve te shiut dhe te zeza nuk ka ekzistuar.

Infrastruktura rrugore

Eshte hartuar projekt ideja dhe preventivi, shoqeruara me specifikimet teknike perkatese per rehabilitimin e rruges.Bashkengjitur eshte paraqitur prerja e rruges.Jepen detajet e rruges .

PRERJE TERETHORE

